



**VENDIM**

**Nr. 5, Datë 27.01.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
RREGULLAVE TË CILËSISË SË FURNIZIMIT DHE PERFORMACËS SË  
SIGURISË SË RRJETIT TË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16 dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punes për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores të Cilësisë së Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit dhe draftin përkatës,

**Konstatoi se:**

Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 5171/5 Prot., datë 15.12.2015 ka depozituar në ERE për miratim konform nenit 7 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, “Rregullat për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit.“

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores të Cilësisë së Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

